



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:192239

Datë: 03.06.2024

Numri i dokumentit: 05771332

KPPP.nr. 1452/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me gjyqtarin Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Art Motion” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810200866 dhe me seli në Prishtinë, rr. “Lidhja e Pejës, Zona Industriale, kundër debitorit Radio Televizioni i Kosovës (RTK), me numër fiskal 600294657 dhe me seli në Prishtinë, rr. “Xhemajl Prishtina” nr. 12, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 1493/23 të datës 18.08.2023, lëshuar nga Përmbartuesi Privat Isa Gacaferi me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 03.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Radio Televizioni i Kosovës (RTK), ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr. 1493/23 të datës 18.08.2023, lëshuar nga Përmbartuesi Privat Isa Gacaferi, ANULOHET.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të “Art Motion” Sh.P.K., ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr. 1493/23, të datës 18.08.2023, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumenteve – Faturës nr. F22-12-0000493, e datës 01.12.2022; Faturës nr. F22-11-0000634, e datës 01.11.2022; Faturës nr. F-22-10-0000509, e datës 01.10.2022; Faturës nr. F22-08-0001436, e datës 01.08.2022; Faturës nr. F22-07-0000533, e datës 01.07.2022; Faturës nr. F22-07-0001115, e datës 01.06.2022; Faturës nr. F22-04-0001222, e datës 01.04.2022; Faturës nr. F22-09-0000576, e datës 01.09.2022; Faturës nr. F22-05-0000611, e datës 01.05.2022; Faturës nr. F22-02-0000844, e datës 01.02.2022; Faturës nr. F22-01-0000902, e datës 01.01.2022; Faturës nr. F21-12-0000467, e datës 01.12.2021; Faturës nr. F21-11-0000760, e datës

01.11.2021; Faturës nr. F21-10-0000607, e datës 01.10.2021; Faturës nr. F21-09-0000585, e datës 01.09.2021; Faturës nr. F21-07-0000424, e datës 01.07.2021; Faturës nr. F22-03-0001172, e datës 01.03.2022; Faturës nr. F23-01-0000546, e datës 01.01.2023, duke detyruar debitorin Radio Televizioni i Kosovës që në emër të borxhit nga faturat e lartcekura t'ia paguaj kreditorit shumën e përgjithshme prej 49,481.46 EUR (me shkronja: dyzet e nëntë mijë e katërqind e tetëdhjetë e një euro e dyzet e gjashtë cent) me kamatëvonesë prej 8%, duke filluar nga data kur kërkesa është bërë e arritshme e deri në pagesën definitive, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përbarimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të këtij propozimi.

Debitori, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim ndaj Urdhrit Përbarimor duke theksuar se faturat në bazë të së cilave është lejuar urdhri përbarimor nuk janë paraqitur në origjinal apo kopje e vërtetuar, ashtu që Përbaruesi Privat ka lëshuar urdhrin për përbarim pa u plotësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e tij. Më tej, ka theksuar se me kreditorin ka lidhur kontratën nr. 0901/21, të datës 30.04.2021, ku objekt i kontratës ishte ofrimi i shërbimeve të internetit, e i cili shërbim do të kompensohej me hapësirën publicitare nga ana e debitorit. Ka shtuar se nuk kontestohet fakti që i njëjti ka pranuar shërbimet nga ana e kreditorit, por edhe kreditorit i është ndarë hapësira publicitare për periudhën e përcaktuar në kontratë. I ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përbarimor të anulohet.

Kreditori, në përgjigje ndaj prapësimit ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit, duke theksuar se me debitorin kanë lidhur kontratën për shërbime të internetit, ku objekt i kontratës ka qenë ofrimi i shërbimeve të internetit për RTK, e i cili do të kompensohet me hapësirë reklamuese. Konform kësaj kontrate debitori ka pranuar shërbimin e internetit nga Artmotion, mirëpo e ka kundërshtuar ofrimin e shërbimit të tij ndaj Artmotion, këtu kreditorit, ashtu që detyrimin e akumuluar e ka kundërshtuar me arsyetimin se ky shërbim do të duhet të shfrytëzohej brenda periudhës kontraktuese. Ka shtuar se debitori e ka pranuar detyrimin për shërbimin që ka pranuar në shumën si në propozimin për përbarim, e kjo është vërtetuar edhe përmes procesit të barazimit të datës 23.03.2023. Duke qenë se faturat i ka dërguar në baza mujore përmes adresës elektronike, e të njëjtat debitori i ka pranuar, andaj mbi këtë bazë të njëjtat paraqesin dokument të besueshëm dhe të përshtatshme për përbarim. Për këto arsye, i ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit si të pa bazuar, ndërsa urdhri përbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, si dhe deklarimeve të kreditorit në përgjigje ndaj prapësimit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-

139 për Procedurën Përmbaremore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar andaj u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “*Përmbaremi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm*”, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me nenin 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbaremi po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*”.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumentet: Faturë nr. F22-12-0000493, e datës 01.12.2022; Faturë nr. F22-11-0000634, e datës 01.11.2022; Faturë nr. F-22-10-0000509, e datës 01.10.2022; Faturë nr. F22-08-0001436, e datës 01.08.2022; Faturë nr. F22-07-0000533, e datës 01.07.2022; Faturë nr. F22-07-0001115, e datës 01.06.2022; Faturë nr. F22-04-0001222, e datës 01.04.2022; Faturë nr. F22-09-0000576, e datës 01.09.2022; Faturë nr. F22-05-0000611, e datës 01.05.2022; Faturë nr. F22-02-0000844, e datës 01.02.2022; Faturë nr. F22-01-0000902, e datës 01.01.2022; Faturë nr. F21-12-0000467, e datës 01.12.2021; Faturë nr. F21-11-0000760, e datës 01.11.2021; Faturë nr. F21-10-0000607, e datës 01.10.2021; Faturë nr. F21-09-0000585, e datës 01.09.2021; Faturë nr. F21-07-0000424, e datës 01.07.2021; Faturë nr. F22-03-0001172, e datës 01.03.2022 dhe faturë nr. F23-01-0000546, e datës 01.01.2023, në bazë të së cilave është lejuar përmbaremi nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokumente të besueshme sipas nenit 29.3 të LPP-së, për faktin se faturat e lartcekura, nuk përmbajnë nënshkrimin apo vulën e debitorit tek pranuesi i faturës, e rrjedhimisht rezulton se të njëjtat nuk janë pranuar me rregull nga debitori.

Gjykata vlerësoi pretendimet e kreditorit se faturat e bashkangjitura në propozimin për përmbaremi i janë dërguar debitorit përmes adresës elektronike, por që në asnjërën prej komunikimeve të ofruara nga kreditori nuk ka konfirmim të pranimit të faturave nga ana e debitorit, përkatësisht konfirmim të detyrimeve që rrjedhin nga këto fatura.

Gjykata vlerësoi po ashtu dokumentin proces i barazimit i datës 23.03.2023 i bashkangjitur nga kreditori në propozimin për përmbaremi, ku konstatohet se palët ndërgjyqëse janë pajtuar që gjendja e arkëtueshme nga debitori për kreditorin për periudhën deri më datë 31.12.2022 është në vlerë prej 49,481.46 EUR, por që nga vet komunikimi elektronik i datës 13.04.2023 i dërguar nga kreditori për debitorin, rezulton se barazimi i lartcekur, ka pasur të bëjë me vlerën e hapësirës

publicitare-shërbim i marketingut të cilën kreditori ka pretenduar se i është bërë e arritshme ndaj debitorit por që nga ky dokument, nuk rezulton se debitori, është pajtuar që të paguaj për kreditorin vlerën e kërkuar në propozimin për përmbarim në emër të hapësirës publicitare të pashfrytëzuar. Për më tepër, shuma e saktësuar në dokumentin e lartcekur, nuk përputhet me shumën e kërkuar në propozimin për përmbarim, andaj gjykata erdhi në përfundim se kreditori, nuk ka ofruar prova të mjaftueshme nga të cilat vërtetohet se debitori është pajtuar me detyrimet sipas faturave objekt i këtij përmbarimi.

Në këtë drejtim, në mungesë të nënshkrimit të debitorit në faturat kontestuese, nga i cili nënshkrim do konfirmohej se shumata e faturave të lartcekura paraqesin shumën për të cilin debitori detyrohet ndaj kreditorit, gjykata vendosi që prapësimi i debitorit të pranohet ndërsa urdhri për lejimin e përmbarimit të anulohet.

Nga si më sipër, e në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1452/23, datë 03.06.2024

Gjyqtari

Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.